Në bazë të nenit 5 të Ligjit për Buxhetin e Rishikuar për vitin 2020 nr.07/L-14, sipas nenit 40.2 (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 26 pika 2. të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit me dt.10.09.2020, merr këtë:

# VENDIM

## PËR SHFRYTËZIMIN E REZERVËS KOMUNALE

I.

Merret Vendimi për Shfrytëzimin e rezervës komunale të vitit fiskal 2020, të cilat do të ridestinohen sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

1.Projekti Ndertimi i varrezave te deshmoreve (Lapidari në fshatin Belle) kodi i projektit 49821 ne vlere prej 35.000,00 €,
2.Ndertimi i shëtitores dhe tretuareve ne qytet kodi 49734 shume 50.000,00 €,
3.Ndertimi i Objekti Higjiena dhe infrastrukture kodi 49767 shume 20.000,00 €,
4.Projekte bashkëfinancimi me IPA EU - Vija Ferrata kodi 49967 shuma 20.000,00 €,
5.Mallra shërbime shpenzime operative 100.000,00€ programi zyra e kryetarit 16015
6.Mallra shërbime shpenzime COVID 19 shuma 50.389,00 €, programi Buxheti 17515
6.Mallra dhe shërbime administrata e arsimit pagesa për dru të shkollave 36.380,00 €,
7.Projekti Mirëmbajtje investive kodi 49888 shuma prej 285.000,00 €.

II.

Mjetet e destinuara për investime kapitale do të alokohen në projekt kodet ekzistuese të buxhetit pasi që nuk lejohen projekt kode të reja ndërsa mjetet për mallra dhe shërbime do të alokohen në programin e Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa sipas kodit të shpenzimit.

III.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim njoftohen:MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.VIII-1
Deçan,dt.10.09.2020

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit :
Haki Shehaj

K:Komunal 22491
01 1009 20